



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 317 Prot

Tiranë, më 24. 09 2014

VENDIM Nr. 337, dt. 08.09.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.09.2014, mbasi shqyrtoi raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në kuadër të kërkesës për miratimin e projektit "**Linja ajrore 110 KV Babicë (Vlorë) - Sarandë**" – OST sh.a.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit arkeologjik" të realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në kuadër të kërkesës për miratimin e projektit "**Linja ajrore 110 KV Babicë (Vlorë) - Sarandë**" – OST sh.a.
- II. Para fillimit të punimeve, të kryehen sondazhe arkeologjike në vendin e parashikuar për ndërtimin e shtyllave Nr. 14 (Kaninë), Nr. 62 dhe Nr. 63 (Mazhar).
- III. OST sh.a të marrë masa për zhvendosjen e shtyllës Nr. 86, Gjorm.
- IV. Të ndryshohet projekti i rrugës ndihmëse, që do të shërbejë për ndërtimin e shtyllave Nr. 244, 245 dhe 246, pasi dëmton kalldrëmin e rrugës ekzistuese për në Manastirin e Shën Mërisë të Kremnovës, Piqeras.
- V. OST sh.a të marrë masa për kryerjen e sondazheve arkeologjike nga institucione shtetërore dhe private të specializuara të fushës përkatëse, përpara fillimit të punimeve, sipas përcaktimit të pikës II të këtij vendimi.
- VI. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikëqyrja arkeologjike periodike e punimeve nga specialistë arkeologë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO